

BULETINI MUJOR

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

www.ild.al | Info@ild.al



Inspektori i Lartë i
Drejtësisë



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani
@ILD_Albania

EDUKIMI LIGJOR QË NË BANKAT E SHKOLLËS





INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË ME NXËNËSIT E BAJRAM CURRIT PËR EDUKIMIN LIGJOR

Bajram Curri, më 8 qershor 2023

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani u bë pjesë e aktivitetit edukativ të nxënësve të shkollës “Besëlidhja e Malësisë”, në qytetin e Bajram Currit.

Aktiviteti është pjesë e synimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për nxitjen e edukimit ligjor edhe në arsimin parauniversitar, një proces që ka filluar në auditorët e studentëve të drejtësisë së universiteteve publike në vend.

Nxënësit e klasave të 9-a të kësaj shkolle, që kremton këtë vit 100 vjetorin e saj kishin përgatitur një kazus ligjor, të cilin e debatuan të ndarë në dy grupe, rreth influencave, që sig-

urohen nga pozita shoqërore përballë të drejtës në gjykatë. Me role debatuesish, nxënësit paraqitën argumentime mbi të drejtën ligjore, morale, etike e praktike dhe mësimet e nxjerra, se të bësh gjënë e duhur është zgjedhja më e mirë, edhe kur janë mundësitë për përfitim të padrejtë.

Duke i përgëzuar nxënësit për përgatitjen, argumentat e fortë dhe debatin dinamik, Inspektori i Lartë i Drejtësisë iu përgjigj pyetjeve të tyre mbi punën e ILD-së dhe kontributin e shoqërisë për një shtet të së drejtës. Z. Metani veçoi konkluzionin e përcjellë nga debati, pikërisht edukimin mbi luftën ndaj padrejtësisë dhe këmbënguljen për të marrë drejtësi larg çdo lloji ndikimi, si një proces sfidues për çdo shoqëri, por edhe një detyrë qytetare.



“Drejtësia para se të jetë një dokument apo ligj, që e lexon dhe zbaton gjyqtari e prokurori është së pari një vlerë shoqërore “,- u shpreh Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

“Nëse ti je i ndershëm dhe jep kontributin tënd për një shoqëri me kulturën e drejtësisë, atëherë reagimi yt dhe i shoqërisë do jetë i fortë

ndaj padrejtësisë. Kur ti nuk do të pranosh të përfitosh padrejtësisht diçka të pamërituar, atëherë padyshim që do të luftosh, që edhe të tjerët mos të jenë përfitues të gjërave që nuk u takojnë.”

Z. Metani i shoqëruar nga anëtarë të Zyrës së ILD-së vizitoi ambientet e klasës-muze të





shkollës dhe bashkëbisedoi me stafin pedagogjik. Gjatë kësaj vizite, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbi punën e ILD-së dhe shkëmbeu pikëpamje e pati edhe një takim informal me drejtues të ide për edukimin që në bankat e shkollës të pushtetit vendor ku u bisedua për perspektivat e nxënësve, me kulturën e të drejtës dhe angazhimin qytetar kundër padrejtësisë. zhvillimit të qytetit dhe mundësive që ofrohen për të rinjtë.





METANI INFORMON KOMISIONIN E LIGJEVE MBI PUNËN E ZYRËS SË ILD-SË PËR VITIN 2022

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani paraqiti para Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, raportin vjetor të punës së institucionit gjatë vitit 2022.

Në fjalën e tij, z. Metani u ndal tek niveli i zbatimit të 11 rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2022, përmes një sintheze të nivelit të zbatimit të tyre, me përmeshjen



z. Metani u ndal në disa nga momentet kyce të ecurisë së punës gjatë vitit 2022, në drejtim të verifikimit të ankesave, hetimit disiplinor, inspektimeve tematike, bashkëpunimit institucional e ndërkombëtar, transparenca, arritjet dhe prioritetet për vitin 2023.

e 9 rekomandimeve dhe 2 të tjerave në proces.

Më tej z. Metani u ndal në disa nga momentet kyce të ecurisë së punës gjatë vitit 2022, në drejtim të verifikimit të ankesave, hetimit disiplinor, inspektimeve tematike, bashkëpunimit institucional e ndërkombëtar, transparenca, arritjet dhe prioritetet për vitin 2023.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë iu përgjigj pyetjeve të deputetëve të Komisionit mbi aspekte të ndryshme të veprimtarisë së ILD-së.

Raportin e plotë të punës së ILD-së për vitin 2022 e gjeni në linkun:

<https://ild.al/sq/2023/05/05/raporti-i-punes-per-vitin-2022/>





Gjatë asistimit të ankuesve

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas

komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

Gjatë muajit Qershor 2023, Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun ka pritur 17 ankues, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe 12 telefonata me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose Informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.

Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuesi të drejtën për t'u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuesin për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga qytetarët, personat juridikë, grupet e

interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit amanta.jasa@ild.al.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

SHIFRA MUJORE

Gjatë muajit Qershor 2023, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur 11 kërkesa për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuesit t'i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).

ANKIMI NË ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion. Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankese, i cili:

- * mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- * të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë

në adresën Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Godina nr.13, Tiranë.

- * mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD www.ild.al, në seksionin "Si pranohen ankesat".



**INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË Z. ARTUR METANI MIKPRITI
SHEFIN E INSPEKTORATIT TË DREJTËSISË SË FRANCËS, Z.
CHRISTOPHE STRAUDO**

Me ftesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë z. Artur Metani e me mbështetjen e CEPEJ, projekti i përbashkët i Bashkimit Evropian e Këshillit të Evropës, zhvilloi një vizitë pune në Shqipëri, Presidenti i Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit (RESIJ), njëkohësisht shef i Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë së Francës, z. Christophe Straudo.

Axhenda e vizitës parashikonte vizita me drejtues të institucioneve në Tiranë, në të cilat ishte e pranishme edhe Ambasadorja e Francës në Shqipëri, znj. Elisabeth Barsacq.

Në takimin dypalësh Metani-Straudo, biseda mes dy homologëve u fokusua tek angazhimi i tyre, si pjesë e RESIJ, për të kontribuar për një sistem





drejtësie që bazohet tek parimet e mëdha të respekt të balancës me interesin publik për administrimin e drejtësisë. pavarësisë, paanësisë dhe barazisë para ligjit.

Ndërsa duke u ndalur tek institucionet respektive, Në takim me nënkryetaren e Partamentit, znj. z. Metani dhe z. Straudo bashkëndanë qëndrimin, Ermonela Felaj u shpreh se Kuvendi vlerëson dhe mbështet fuqimisht funksionimin e Inspektorit të mbështet fuqimisht funksionimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rritjen e performancës e në inspektimi duhet të jetë gjithnjë i pavarur, e në





kontributit të këtij institucioni, në drejtim të rritjes së performancës së sistemit, vendosjes së standardeve më të mira të punës në sistemin e drejtësisë dhe plotësimit të pritshmërive e besimit të publikut.

Znj. Felaj nënvizoi edhe rëndësinë e bashkëpunimit të ILD-së me Inspektoratin e Përgjithshëm të Drejtësisë së Francës, duke u nisur edhe nga ngjashmëria e legjislacionit penal dhe civil të të dy vendeve.

Në takimim me ministrin e Drejtësisë, z. Ulsi Manja vlerësoi kontributin e Francës në konsolidimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, edhe përmes bashkëpunimit me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, në kuadër të RESIJ.

Ministri i Drejtësisë tha se me miratimin e reformës në drejtësi në Shqipëri, institucionet e drejtësisë janë krejt të pavarura në punën e tyre, ndërsa sfida tani është zbatimi i kësaj reforme,



Presidenti i RESIJ nënvizoi se ILD me statusin e vëzhguesit është shumë prezent në Rrjet dhe angazhohet duke sjellë kontributin e vet dhe në këtë kontekst, brenda RESIJ nuk ka dallime mes shteteve anëtarë të BE-së dhe shteteve candidate të BE-së. Nga ana tjetër, z. Straudo nënvizoi se Franca dhe Rrjeti European i Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë do të vijojnë të jenë mbështetës për ILD-në.

me përpjekjen e të gjithë aktorëve në vend, sidomos institucionet të reja të sistemit, sic është Inspektori i Lartë i Drejtësisë, puna e të cilit po ndihet fort në sistem, jo vetëm me trajtimin e ankesave apo çështjeve individuale, por me dimensionin e rekomandimeve, që kanë dalë nga kryerja e inspektimeve tematike.

Në takimin e zhvilluar në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, kryetarja znj. Naureda Llagami vlerësoi mes të tjerash bashkëpunimin shumë korrekt me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

“Puna e z. Metani dhe e ekipit të tij ka qenë profe-

sionale dhe ka reflektuar standarde shumë të mira, duke ndikuar kështu në punën e gjykatave në vend,- tha kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke shtuar se “pikërisht për shkak të kësaj pune dhe besimit, që po krijohet tek ky institucion, mendonte se në të ardhmen, natyrshëm, do të vijë edhe rritja e performancës në punën e gjykatave.”

Në takimin me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, kryetari z. Alfred Balla nënvizoi punën profesionale të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në raport me KLP-në, si institucioni që vendos për masat disiplinore të propozuara nga ILD për prokurorë.



Nga ana tjetër kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë vlerësoi se puna e z. Metani në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar është impresionuese, dicka që e ka konstatuar vetë, me pjesëmarrjen në Konferencën Ndërkombëtare të Shërbimeve eurpiane të Inspektimit të Drejtësisë, që organizoi ILD vitin e kaluar në Tiranë, për të folur mbi pavarësinë e magistratëve.

Në takimin në Gjykatën e Lartë, z. Straudo i shoqëruar nga z. Metani u prit nga kryetari z. Sokol Sadushi dhe anëtarët z. Ilir Panda e z. Ervin Pupe. Z. Sadushi pasi bëri një prezantim të Gjykatës së Lartë, u ndal tek roli i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që e veçoi si institucionin më të fuqishëm të sistemit, për shkak të kompetencave që i ka dhënë kushtetuta, e duke vlerësuar marrëdhënien profesionale me ILD-në.

Në këto takime z. Christophe Straudo vlerësoi mbështetjen e institucioneve shqiptare për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe kontributin e ILD-së për paanshmërinë e sistemit të drejtësisë

dhe forcimin e shtetit të së drejtës, si gur themeli në rrugëtimin e Shqipërisë drejt antarësimit në BE.

Presidenti i RESIJ nënvizoi se ILD me statusin e vëzhguesit është shumë prezent në Rrjet dhe angazhohet duke sjellë kontributin e vet dhe në këtë kontekst, brenda RESIJ nuk ka dallime mes shteteve anëtarë të BE-së dhe shteteve kandidatë të BE-së. Nga ana tjetër, z. Straudo nënvizoi se Franca dhe Rrjeti European i Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë do të vijojnë të jenë mbështetës për ILD-në.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Metani vlerësoi bashkëpunimi me RESIJ është një eksperiencë shumë e mirë profesionale për ILD-në, ndërsa evidentoi përpjekjet e institucionit që drejton, për të vendosur çdo ditë norma pune, që në pamje të parë mund të duhen të thjeshta, por që padyshim i shërbejnë të ardhmes, një sistemi drejtësie që i shërben qytetarëve, me standartet më të mira të së drejtës. Edhe vizita e z. Straudo, sipas z. Metani i shërben kësaj filozofie pune të ILD-së.





INSPEKTIMET TEMATIKE NË FOKUS TË TRAJNIMIT TË EKIPIT TË ILD-së

Paralelisht me vizitën në Tiranë të z. Christophe Straudo, President i RESIJ dhe Shef i Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë së Francës, dy inspektorë të përgjithshëm të Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë së Francës, inspektorja magjistrate Marjorie Obadia dhe inspektori i Përgjithshëm Jean-Louis Daumas zhvilluan një trajnim dy ditor me ekipin e ILD-së, me mbështetjen e CEPEJ, projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës për drejtësinë.

Në nisje të trajnimit, në fjalën përshëndetëse, Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani vlerësoi se shkëmime të tilla profesionale janë një mënyrë pune për institucionin që drejton, në mënyrë që ekipi i ILD-së të ketë performancën më të lartë të punës, bazuar në ekspertizën e praktikën më të mira të institucioneve homologe

europiane apo edhe të tjerë.

Shef i Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë së Francës, z. Christophe Straudo nënvizoi gatishmërinë e palës franceze për të dhënë pakursim ekspertizën e tyre për kolegët shqiptarë dhe ky trajnim e dëshmon këtë.

Në dy ditët e trajnimit, inspektorët francezë bënë një prezantim të Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë të Francës, me fokus tek inspektimet tematike dhe mbështetëse, kontrollet operative dhe standardet e referimeve, metodologjinë e inspektimeve funksionale, hetimet administrative ndaj magistratëve dhe metodologjinë e përdorur, duke diskutuar mbi raste konkrete, problematika dhe zgjidhje.

Në trajnim morën pjesë inspektorët e Zyrës së



ILD-së, ndihmës inspektorët, anëtarë të kabinetit dhe të drejtorisë së hartimit të akteve shërbi-meve juridike.

Inspektori Jean-Louis Dumas, përgjegjës i departamentit të ekzekutimit të vendimeve pranë Inspektoratit të Përgjithshëm të drejtësisë së Francës, me eksperiencë të gjatë si drejtues në

shërbimet penitenciare dhe Inspektorja magjistrate Marjorie Obadia zhvilluan një takim me drejtorin e përgjithshëm të burgjeve, z. Admir Abrija, i cili i njohu me sistemin e burgjeve në Shqipëri, menaxhimin e tyre, dimensionin social të sistemit, rritjen profesionale të stafit dhe iu përgjigj pyetjeve të bashkëbiseduesve, që bënë krahasimet me modelin francez.





INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË MERR PJESË NË ASAM- BLENË VJETORE TË RESIJ


Sofje, 21 Qershor 2023

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani zhvilloi një vizitë pune në Sofje të Bullgarisë, ku mori pjesë në mbledhjen vjetore të Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ), pjesë e të cilit, me statusin e vëzhguesit është prej dhjetorit 2021 edhe Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në pjesën e parë të punimeve, u paraqit një raport studimor krahasues i shërbimeve të Inspektimit të Belgjikës, Bullgarisë, Francës, Italisë, Portugalisë, Rumanisë, Spanjës dhe Shqipërisë, i përgatitur mbi

fushën e kontrollit dhe administrimit të drejtësisë, të secilit nga vendet përkatëse, me konstatimet e ngjashmërive dhe të veçantave, si dhe perspektivat e bashkëpunimit e prioritetet e RESIJ brenda dhe jashtë Rrjetit.

Në pjesën e dytë të punimeve, Asambleja e përgjithshme e RESIJ bëri një vlerësim të situatës politike, administrative e financiare të Rrjetit dhe miratoi ndryshimet në Statut, lidhur me organizimin e brendshëm. Në këtë mbledhje, anëtarët zgjodhën kryesuesin e ri të RESIJ, Rumaninë, e cila pasoi në drejtim Francën, themeluese dhe





kryesuese e Rrjetit prej fillimit. Në diskutimet e tyre, anëtarët vlerësuan se me ndryshimet e reja në Statut, Rrjeti Evropian i Shërbimeve të Inspeksionit të Drejtësisë forcoi strukturën e vet, si një mekanizëm premtues për zhvillimin e vlerësimeve publike evropiane ose të inspektimeve për llogari të instancave evropiane dhe ndërkombëtare. Nëpërmjet vlerësimeve, duke kombinuar qasjet në terren dhe të dhënat krahasuese,

RESIJ ka ditur të pozicionohet në rolin e një pale të tretë të besuar publike. Aktivitetet e kryera si për llogari të Komisionit të Bashkimit Evropian (DG Just- Departamenti për Drejtësinë i Komisionit Evropian), ashtu edhe të Këshillit të Evropës (CEPEJ), prej 5 vitesh e dëshmojnë këtë. Sipas parimit të rotacionit mes vendeve

pjesëmarrëse, Asambleja e ardhshme e RESIJ do mbahet në Tiranë më 15-16 Dhjetor 2023.

Gjatë vizitës së punës në Sofje, Inspektori i Lartë i Drejtësisë bashkë me kolegët e RESIJ morën pjesë në konferencën e organizuar me rastin e 15 vjetorit të Inspektoratit të Këshillit të Lartë Gjyqësor të Bullgarisë, ku magjistratë vendas referuan mbi zhvillimin historik, zgjerimin e kompetencave dhe arritjet e praktikave të mira të Inspektoratit bullgar, ndërsa magjistratë të tjerë evropianë, paraqitën modele të inspeksionit të drejtësisë në vendet e tyre, qasjet e ndryshme por rregullat e përbashkëta, lidhur me metodat e kryerjes së inspektimeve dhe vlerësimin e aftësive e përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.



QERSHORI NË ILD ME SHIFRA

Gjatë muajit **Qershor** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **41 ankesa**, të paraqitura nga qytetarë.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit **Qershor 2023**. Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

VERIFIKIME

24 vendime verifikimi, nga të cilat:

- ⇒ 11 vendime verifikimi (praktika të ILD-së);
- ⇒ 13 vendime verifikimi (dosje të mbartura nga ish KLD);

HETIME DISIPLINORE

1 vendim për vazhdim hetimi disiplinor për 5 subjekte (gjyqtarë)


ARKIVIME

98 vendime arkivimi nga 119 praktika të shqyrtuara konkretisht :

- ◆ 34 vendime arkivimi pas verifikimit nga praktika të ILD, nga të cilat
 - ⇒ 30 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar;
 - ⇒ 4 vendime arkivimi pas verifikimit
- ◆ 64 vendime arkivimi nga praktika të trajtuara (dosje të mbartura nga ish KLD):
 - ⇒ 45 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar;
 - ⇒ 19 vendime arkivimi pas verifikimit

SHPALLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Qershor** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për **5 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarrtshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në standat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në standat e bashkive nga vijnë ankuesit. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në total ka bërë ka bërë **267 shpallje publike**.



INFORMACION

Për shkak të rikonstruksionit të godinës, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë zhvendoset për një periudhë kohore në adresën Rr. "Abdi Toptani", Nd. 5, kati 3, Tiranë (tek Avokatura e Shtetit).

Oraret për komunikimin me qytetarët që duan informacion apo të paraqesin ankesë pranë ILD-së mbeten të pandryshuara. Ekipi i Zyrës së ankesave do i mirëpresë cdo ditë pune nga ora 09.00 – 14.00.

Pritja e qytetarëve do të kryhet në katin e parë të institucionit.

QERSHOR 2023


Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

© ILD



KONTAKT ILD

WEB: ild.al
EMAIL: info@ild.al
ADRESA: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,
 Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD
 Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com)

[Kliko për të ndjekur spotin prezantues të ILD](#)